

**AKTI I THEMELIMIT**  
**I**  
**SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“RentHub” sh.p.k**

Sot në datën 31.01.2024 (dymijë e njëzetekatër), unë **Bjorni Sollaku**, atësia Theodor, datëlindja 19.03.1994, lindur në Tiranë, banues në Tiranë, Rruga “Perlat Rexhepi”, pall.10, ap. 49, Tiranë, titullar i pasaportës me nr.BB7558872, lëshuar nga autoritetet Shqiptare në datën 04.08.2020, vendosa të themeloj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar, **“RentHub” sh.p.k**, mbështetur në nenin 2 paragrafi “B” i Ligjit “Për sanksionet dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lirë të veprimtarisë private, të pavarur dhe të privatizimit”, në ligjin 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare”, i ndryshuar, në të cilën jam Ortak i Vetëm dhe për këtë qëllim hartoj Aktin e Themelimit, me përmbajtjen si vijon:

**NENI 1**

**EMRI**

Shoqëria tregtare private me përgjegjësi të kufizuar emërtohet **“RentHub” sh.p.k**, e cila këtu më poshtë do të quhet “Shoqëria”.

**NENI 2**

**FORMA**

**2.1** Kjo shoqëri është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

**NENI 3**

**BAZA JURIDIKE**

**3.1** Shoqëria krijohet në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ajo e fiton personalitetin juridik pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

**NENI 4**

**SELIA**

**4.1** Selia e shoqërisë do të jetë në Durrës, Rinas, Aeroporti Ndërkombëtar I Tiranës "Nënë Tereza" Terminali I mbërritjeve të pasagjereve.

**4.2** Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të ortakut të vetëm.

**NENI 5**

**TERRITORI**



**5.1** Shoqëria e zhvillon aktivitetin si në territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj.

Shoqëria mund të krijojë degë (filiale) ose përfaqësi, si në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

## **NENI 6 OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Veprimtari në fushën e dhënies me qera të mjeteve të transportit si makinave, motorëve, minibus, autobus, kamion, mjete lundruese etj. Shërbim me qera me drejtues mjete për çdo mjet të lëvizshëm të lejuar për qarkullim dhe transport udhëtarësh e mallrash në rang kombëtar e ndërkombëtar etj.

Krijimi i Agjensive Turistike, organizimin e guidave turistike, brenda dhe jashtë vendit. Veprimtari në import-eksport, shitjen dhe blerjen e mjeteve motorike. Veprimtari në kryerjen e shërbimeve dhe servisit për riparimin dhe mirembajtjen e mjeteve motorike.

## **NENI 7 KOHËZGJATJA**

**7.1** Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pacaktuar.

## **NENI 8 KAPITALI THEMELTAR**

**8.1** Kapitali Themeltar i Shoqërisë është **100 lekë** (njëqind). Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga Ortaku i Vetëm.

## **NENI 9 KONTRIBUTET**

**9.1** Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi i Ortakut të Vetëm të Shoqërisë **“RentHub” shpk**.

## **NENI 10 PJESËT E KAPITALIT THEMELTAR**

**10.1** Kapitali themeltar është i ndarë në 1 kuotë plotësisht të shlyer.

## **NENI 11**

**11.1 Administrimi** i shoqërisë do të bëhet nga një administrator. Administrator i shoqërisë është **Mariglen Çullhaj**, atësia Petrit, datëlindja 09.12.1988, lindur në Tiranë, Shqipëri, banues në Tiranë, rruga “Medar Shtylla”, titullar i pasaportës me nr. BG1745921, lëshuar nga autoritetet shqiptare në datën 26.10.2010. Ai ushtron këtë detyrë për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi. Afati i emërimit të administratorit do të jetë 31.01.2024-30.01.-2029.



**NENI 12**  
**DISPOZITA TE FUNDIT**

**12.2** Shoqëria do të rregullohet, përveç ketij Akti Themelues edhe me norma të përcaktuara në Statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga Ortaku i Vetëm dhe si i tillë do të miratohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ditën e legalizimit si person juridik në Shqipëri.

**12.3** Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila fuqi të njëjtë ligjore.

**ORTAKU**  
**BJORNI SOLLAKU**

BJORNI SOLLAKU

